



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 141, Datë 25.06.2018

MBI

SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE NR.110, DATË 16.09.2008, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SH.P.K, ME NR.65, SERIA NPM08P NË VEPRIMTARINË E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARQET EOLIKE KARABURUN DHE LLOGARA.

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20 gërma “a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, neneve 16, 104 dhe 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pikës 1, gërma “e” të vendimit të Bordit të ERE nr. 110, datë 16.09.2008, “Për Licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara”, pikës 8.5 të kushteve të Licencës me nr. 65, Seria NPM08P; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për shfuqizimin e licencës së shoqërisë “ENPOWER ALBANIA” sh.p.k.,

Konstatohet se :

- Me Vendimin e Bordit të ERE nr. 110, datë 16.09.2008, është vendosur “Për Licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara”
- Në pikën 1 gërma e), të Vendimit të Bordit të ERE nr. 110, datë 16.09.2008, përcaktohet se mospermbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licensën të pavlefshme.
- Referuar dispozitave të përgjithëshme të licencës pikës 1.2, kjo licencë hyn në fuqi brenda 36 muajve, duke filluar nga momenti i miratimit, për veprimtarinë e ndërtimit dhe instalimit të centralit elektrik dhe për një periudhë prej 30 vjetësh, për prodhimin e energjisë elektrike.

- Shoqëria nuk ka shprehur, si dhe nuk ka paraqitur kërkesë në ERE për zgjatjen e afatit të periudhës së ndërtimit prej nga momenti i licencimit, siç parashikuar në pikën 9.1 të licencës dhe nenin 24, pika 3, e VKM, nr.1701, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”.
- Shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k. nuk ka depozituar në ERE, brenda datës 30 Qershor të çdo viti bilancet financiare vjetore, në kundërshtim me sa parashikuar në pikën 4.2 të licencës me nr. 65, Seria NPM08P.
- Shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k. nuk ka depozituar në ERE, brenda datës 31 Mars të çdo viti, raportin vjetor, lidhur me operimet gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, në kundërshtim me sa parashikuar në pikën 4.3 të licencës me nr. 65, Seria NPM08P.
- Korrespondencat e nisura në adresën e subjektit janë rikthyer në ERE, dhe rezultojnë se subjekti ka ndryshuar adresën e selisë pa njoftuar ERE-n për këtë, në kundërshtim me sa referuar në pikën 4.6 gërma “a” të licencës me nr. 65, Seria NPM08P.
- Shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k. nuk ka bërë pagesën e rregullimit, për periudhën kohore 2012 – 2018, në kundërshtim me pikën 13.1 të licencës me nr. 65, Seria NPM08P, dhe nenin 17 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
- Enti Rregullator i Energjisë kur konstaton se i licencuari nuk ka përmbushur një ose disa nga kushtet e licencës, në referim të pikës 8.5 të kushteve të licencës, mund të rishikojë vlefshmerinë e kësaj licence.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Shfuqizimin e Vendimit të ERE-s me nr. 110, datë 06.09.2008, për “Për Licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara”.
2. Licenca me nr. 65 Seria NPM08P e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., bëhet e pa vlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “Enpower Albania” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.